



VENDIM

Nr. 37 Datë 10.04.2013

PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË “WONDER” SH.A NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2, gërma “a”; 9, dhe nenit 45 pika “4”, dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “ f ”, 5 pika 1 gërma “ f ” dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.04.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “WONDER” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “WONDER” sh.a plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “WONDER” sh.a në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, me një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI